

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
A2Z 2020 SH.P.K

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot, më 01.06.2020 themeluesi i vetem, bazuar ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare", kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

A2Z 2020 SH.P.K

1.2 Themeluesi i vetem i shoqërisë eshte:

Aristir Furxhiu , i biri i Tasi-t i datelindjes 28 Shtator 1953, lindur ne Fier, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar pa pengesa ligjore, identifikuar me karte identiteti me numer F30928007B.

Neni 2
Objekti

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Objekti i veprimtarise ne fushen e nxjerjes, shfrytezimit dhe tregtimit me shumice dhe pakice te a-grupi i pare- minerale metalore, b-grupi i dyte- mineralet jometalore, c-grupi i trete qymyret dhe bitiumet, d-grupi i katert mineralet dhe materialet per ndertim

a-studime dhe projekte te punimeve pyjore

- per hartimin e planeve te menaxhimit te pyjeve, flore spontane, gjetje sportive e turistike dhe kullotave
- per hartimin e projekteve te pyllezimit
- per hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve
- per hartimin e projekteve te shfrytezimit te qendrueshem te pyjeve
- per hartimin e projekteve te menaxhimit te pellgjeve ujembledhese
- per studimin e britshmerise dhe ndertimin e rrugeve pyjore
- per studime fitopatologjike -entomologjike dhe zjarreve ne pyje
- per studimin e menaxhimit te perdonimit te territorit
- per studimin e rezervave gjenetike dhe biodiversitetin

b- zbatime te punimeve pyjore

- per pyllezimet fidanishtet grumbullimin dhe trajtimin e farerave pyjore punimet perqatitore dhe mbjellje fidanesh
- per permisimin e pyjeve ,rincungime dhe trajtim pyjesh me prerje kulturore
- Per shfrytezimin e qendrueshem te pyjeve
- per sistemet malore
- per ndertimin e 2 rrugeve pyjore
- per grumbullimin e vjeljen e qendrueshme te prodhimeve pyjore jo drusore dhe flores spontane mjeksore dhe tanifere
- per ushtrimin e gjetjeve sportive te faunes se eger
- per mbrojtjen nga semundjet, demtuesit dhe zjarret
- per punimet ne kullota, livadhe dhe ndertimin e merementimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota dhe livadhe

2- Germime dheu dhe punime eventuale muratore e beton armeje, prishje e punimeve ne toke te germuar, prodhime material ndertimi, ndertime civile dhe ekonomike ,ndertime rrugore, ndertime hekurudhere, ura dhe vepra arti. Ndertime detare, hidraulike dhe hidroteknike, vepra te veçanta, dhe punime speciale, punime restaurimi, karpetiere, impiante teknologjike dhe te veçanta, punime montimi dhe impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise, punime sherbimi dhe punime topogjodezike.

3-Shoqeria ka per objekt tregimin, import-eksport te mallrave te perdonura, prodhimin dhe perpunimin, tregimin e gurit, drurit dhe neprodukteve te tyre, import-eksportin e mallrave ushimore, industriale, bujqesore, materialeve, lendeve te para, makinerive teknologjike, pjese kembimi e vegla punime, prodhimet antike, bimeve medicinale si edhe mallrat e tjere asistente per transformimin e teknologjise dhe know- how, sherbime konsulente dhe çeshtje organizative ,marketing, administrative, sociale, politike, doganore dhe financiare, ne favor te subjekteve private dhe shteterore perfaqesimi i kompanive vendase apo te huaja, ndermjetesime, transport karburanti dhe vajra lubrifikant, transport mallrash dhe udhetares, hapje restoranti, bari, sherbime hotelerie, dhe hapje agjensi turistike, dhe agjensi doganore, tregetim automjetesh dhe materiale bujqesore, pjese kembimi per to, nxjerje shfrytezimi dhe tregtim me shumice dhe pakice te mineraleve metalore, jometalore, qymyrit dhe bitiumit, mineralet dhe materialet per ndertim, sisteme malore flora dhe fauna, prodhim, qymyri si edhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndeshe me legjislacion shqiptar ne fuqi.

4-Çdo lloj aktiviteti fitim prures qe nuk eshte i ndaluar sipas ligjeve shqiptare.

**Neni 3
Kohëzgjatja**

3.1 Kohezgjatja e shoqerise do te jetë e papercaktuar.

**Neni 4
Selia**

Fier, Lagjia Sheqi i Madh, Rruga Leonardo Murialdo, Banesa Nr 10 .

**Kreu II
Kapitali**


**Neni 5
Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali themeltar fillestari i shoqërisë është 100.000 Lekë

5.2 Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij të mëposhtme:

- Ortaku themelues Aristir Furxhiu eshte zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te per gjithshme 100.000 leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 6



2

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.
- 6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organë Vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarrës i shoqerise.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë.

8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

10.1 Në rastin e marjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

11.1 Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.2 Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

11.3 Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesë, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13
Administrimi

- 13.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 13.2 Emerohet administrator Z. Zyldi Zotaj me karte identiteti E80304067B, i biri i Qazimit datelindja 04.03.1948, per një periudhe 5 vjecare.

Neni 14
Kompetencat e Administratorëve

- 14.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparras asamblesë së përgjithshme përmiratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përparras asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 14.2 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 14.3 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënive kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15
Pergjegjesite e Administratorit

- 15.1 Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas pasojat përkatëse.
- 15.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 15.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

15.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dërnshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesat apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

15.5 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

15.6 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV
Viti finanziar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

16.1 Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1. Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Eksperet

17.1 Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimitarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2 Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatat raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financier vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja –riorganizimi i shoqërisë
Neni 18

Prishja dhe likuidimi

18.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur imbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarës në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

- 18.2 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- 18.3 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

- 20.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- 20.2 Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

21.1 Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR A2Z 2020 SH.P.K

Aristir Furxhiu
(nenshkrimi)

Aristir Furxhiu
Tatj

I. Haf